



MBËSHTESNI NJË KOMUNITET TË VETËORGANIZUAR PREJ 400 PERSONASH NË ATHINË QË RREZIKON TË DËBOHET



Prej 16 vitesh, Komuniteti i Prosfygikave të Okupuara përbën një nga lagjet më të mëdha të vetëorganizuara dhe të çliruara në Evropë. Në këto 8 ndërtesa në zemër të Athinës, 400 banorë nga 27 vende të ndryshme që flasin 20 gjuhë të ndryshme, me fe, ideologji, mosha dhe prejardhje të ndryshme, jetojnë, luftojnë dhe organizohen së bashku. Duke u bazuar në pronësinë komunitare, solidaritetin, ndihmën e ndërsjellë dhe organizimin horizontal, komuniteti jo vetëm që ka strehuar, ushqyer dhe mbështetur mijëra njerëz gjatë 15 viteve të fundit, por gjithashtu tregon se si është e mundur vetëorganizimi kolektiv dhe jeta komunitare, edhe në kohë gjithnjë e më të pasigurta.

Prosfygikat kanë arritur të ndërtojnë një lagje politikisht të bashkuar me shumë apartamente të okupuara (brenda kompleksit të ndërtesave të Prosfygikave) dhe më shumë se njëzet struktura autonome të ndryshme që mbulojnë nevojat bazë të banorëve. Disa prej tyre janë: Qendra për Fëmijë, Struktura e Vetë-Edukimit dhe Kopshti i Vetëorganizuar për Fëmijë; Struktura e Shëndetit dhe farmacia sociale; Struktura e Mikpritjes për Pacientë dhe Shoqëruesit e tyre nga Spitali Onkologjik “Agios Savvas”; Furra Kolektive “Berkin Elvan”; Struktura e Grave.

Komuniteti po bëhet gjithnjë e më i fortë, por e njëjta gjë vlen edhe për represionin që po përjeton. Në verën e vitit 2025, pushteti lokal filloi fshehurazi, përmes një kontrate, plantin për dëbimin e katër ndërtesave të komunitetit dhe rinovimin e tyre, në kuadër të promovimit të gentrifikimit të zonës, i cili pritet të fillojë në korrik të vitit 2026. Qëllimet zyrtare të përshkruara në këtë kontratë, pra shndërrimi i ndërtesave në apartamente për vizitorët e një klinike të afërt dhe në banesa sociale, duhet të zbulohen për atë që janë në të vërtetë: një injorim i realitetit se këto ndërtesa janë tashmë të banuara, se komuniteti përbëhet nga njerëz të shtresave më të ulëta shoqërore që organizojnë 22 struktura që u përgjigjen nevojave bazë dhe se komuniteti tashmë ka hapur një bujtinë për të afërmit e pacientëve të spitalit onkologjik pranë.



SI MUND TË NA NDIHMONI

Kjo është propagandë që synon të legjitimojë zhvendosjen e dhunshme të banorëve aktualë dhe sulmin ndaj një komuniteti të vetëorganizuar.

Ata gënjejnë për të larguar vëmendjen nga qëllimi i vërtetë: të promovojnë gentrifikimin, duke ua ofruar ndërtesat interesave të investitorëve në vend të atyre që tashmë jetojnë në lagje dhe duke shkatërruar një komunitet që lufton.

Më 5 shkurt, një banor i komunitetit filloi një grevë urie deri në vdekje, duke kërkuar nga pushteti lokal të anulojë kontratën, të garantojë të drejtën e banorëve për të qëndruar në shtëpitë e tyre dhe për të vazhduar të ekzistojnë si komunitet, si dhe transferimin e të drejtave të rinovimit të ndërtesave te një subjekt juridik që do të kontrollohet nga komuniteti.

1. Ejani në komunitetin në Athinë, na vizitoni dhe ndihmoni në rinovimin e ndërtesave të komunitetit
2. Bëni një donacion dhe shpërndani online fushatën për mbledhjen e fondeve firefund.net/saveprosfygika
3. Nënshkruani deklaratën tonë me kërkesat e grevistëve të urisë <https://tinyurl.com/prosfygika>
4. Organizoni një ose më shumë aktivitete për mbledhjen e fondeve
5. Bëhu pjesë e fushatës internacionaliste!

Na ndiqni në rrjetet sociale për përditësime të rregullta!



@int.saveprosfygika



@intsavprosfygika



www.saveprosfygika.gr

*Nëse dëshironi të merrni pjesë në këtë përpjekje me ndonjërin nga idetë e mësipërme ose me të tjerë, na dërgoni një email:
save-prosfygika-internationalist@systemli.org*



firefund.net/saveprosfygika